

Thirrje e hapur për projekte të përbashkëta “Qytetet e Binjakëzuara” (Town-Twinning) nën Programin Evropian CERV

Ju kujtojmë se është e shpallur thirrja për projekte “Town-Twinning”, që financohet nga Komisioni Evropian nën Programin Citizens, Equality, Rights and Value Programme (CERV). Objektivi i kësaj thirrjeje për propozime është të promovojë binjakëzimet e qyteteve. Thirrja për projekt propozime synon të mbështesë projekte të përbashkëta mes bashkive nga të paktën dy (2) vende të ndryshme, ku të paktën një nga BE-ja, që do të bashkojnë një numër të gjerë njerëzish, të cilët do të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta që do të krijohen dhe organizohen nga bashkitë e binjakëzuara.

Programi: CERV

Kodi: CERV-2024-CITIZENS-TOWN-TT

Financimi: Komisioni Evropian

Më konkretisht synohet:

- promovimi i shkëmbimeve midis qytetarëve të vendeve të ndryshme;
- dhënia e një përvoje praktike qytetarëve për pasurinë dhe diversitetin e trashëgimisë së përbashkët të Bashkimit dhe për t'i bërë të vetëdijshëm se këto përbëjnë themelin për një të ardhme të përbashkët;
- garantimi i marrëdhënieve paqësore midis evropianëve dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre aktive në nivel lokal;
- forcimi i mirëkuptimit të ndërsjellë dhe miqësisë midis qytetarëve evropianë;
- inkurajimi i bashkëpunimit midis komunave dhe shkëmbimi i praktikave më të mira;
- mbështetja e qeverisjes së mirë lokale dhe
- forcimi i rolit të autoriteteve lokale dhe rajonale në procesin e integritit evropian.

Në përputhje me objektivin e përgjithshëm, projektet mund të trajtojnë temat e mëposhtme (lista nuk është shteruese):

Bashkimi Evropian ndërtohet mbi solidaritetin: solidariteti midis qytetarëve të tij, solidariteti përtej kufijve midis Shteteve Anëtare dhe solidariteti përmes veprimeve mbështetëse brenda dhe jashtë BE-së. Solidariteti është një vlerë e përbashkët që krijon kohezion dhe i përgjigjet sfidave shoqërore. Projektet e Binjakëzimit të Qyteteve do të ndihmojnë në kapërcimin e paragjykimëve në perceptimet kombëtare duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe duke krijuar forume ku mund të diskutohen zgjidhje të përbashkëta në një mënyrë konstruktive. Qëllimi i tyre duhet të jetë të rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e forcimit të procesit të integritit evropian bazuar në solidaritet dhe vlera të BE-së;

Projektet e Binjakëzimit të Qyteteve do t'u japin mundësi qytetarëve të shprehin se çfarë Evrope duan. Debatet e mbështetura nën thirrjen për Binjakëzim të Qyteteve duhet të bazohen në arritjet specifike të BE-së dhe në mësimet e nxjerra nga historia dhe integriti evropian. Ato duhet gjithashtu të reflektojnë mbi tendencat aktuale dhe t'u japin mundësi pjesëmarrësve të sfidojnë euroskeptizmin dhe të sugjerojnë veprime të mundshme që BE-ja mund të ndërmarrë për të nxitur ndjenjën e përkatësisë ndaj Evropës, për të rritur kuptimin e përfitimeve të BE-së dhe për të forcuar kohezionin social dhe politik të BE-së.

Aktivitetet:

- Aktivitete që mund të financohen:
- Workshope
- Seminare
- Konferenca
- Aktivitete trajnuese
- Takime ekspertësh
- Webinare
- Aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimin
- Evente kulturore, festivale, ekspozita
- Mbledhja dhe konsultimi i të dhënave (të ndara sipas gjinisë)

- Zhvillimi, shkëmbimi dhe shpërndarja e praktikave të mira midis autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile
- Zhvillimi i mjeteve të komunikimit dhe përdorimi i mediave sociale

Ndikimi i pritur

- Rritja dhe nxitja e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe miqësisë midis qytetarëve në nivel lokal.
- Mbështetja e qytetarëve nga komunitetet lokale për të përjetuar dhe njohur vlerën e shtuar që ofron BE-ja përmes një qasjeje bazë.
- Rritja e ndjenjës së përkatësisë ndaj BE-së.
- Inkurajimi i një lidhjeje të qëndrueshme midis komunave dhe midis qytetarëve.

Buxheti i parashikuar i thirrjes: EUR 4 000 000.

Buxheti për projekt do të jetë midis 8,455 EUR dhe 50,745 EUR

Aplikuesit e pranueshëm:

- Organizmat publike ose privatë në Shtetet Anëtare dhe ato të Asociuara.
- Aplikanti kryesor dhe partneri/ët e tij të shoqëruar duhet të jenë një organ publik ose një organizatë jofitimprurëse me personalitet juridik të themeluar formalisht në një nga vendet e pranueshme. Ata duhet të jenë qytete/komuna dhe/ose nivele të tjera të autoriteteve lokale ose komitetet e tyre të binjakëzimit ose organizata të tjera jofitimprurëse që përfaqësojnë autoritetet lokale.
- Projekti duhet të jetë transnacional dhe duhet të përfshijë bashki nga të paktën dy (2) vende të pranueshme, nga të cilat të paktën një (1) është Shtet Anëtar i BE-së.
- Aktivitetet duhet të zhvillohen në cilindo prej vendeve të pranueshme që marrin pjesë në projekt.
- Eventet duhet të përfshijnë një minimum prej 50 pjesëmarrësish të drejtpërdrejtë, nga të cilët të paktën 25 janë "pjesëmarrës të ftuar ndërkombëtarë".

Aktivitetet e pranueshme:

- Eventet e Binjakëzimit të Qyteteve duhet të përfshijnë minimalisht 50 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, nga të cilët të paktën 25 pjesëmarrës duhet të jenë "pjesëmarrës ndërkombëtarë të ftuar". "Pjesëmarrësit ndërkombëtarë të ftuar" janë delegacione nga partnerët e asociuar që udhëtojnë nga një vend në një tjetër që organizon një ngjarje Binjakëzimi Qytetesh.
- Eventet online nuk janë të pranueshme.
- Projektet duhet të demonstrojnë një vlerë të shtuar të veçantë në përshkrimin e aktiviteteve (p.sh. risi, praktikat më të mira).
- Aplikimet që përsëriten nga viti në vit të paraqitura nga i njëjti aplikant duhet të demonstrojnë në aplikim vlerën e shtuar të veprimit të ri/vazhdimin të veprimit.
- Projektet duhet të marrin parasysh rezultatet e projekteve të mbështetura nga programet e tjera të financimit të BE-së.
- Projektet duhet të jenë në përputhje me interesat dhe prioritetet e politikave të BE-së (si mjedisi, çështjet sociale, siguria, politika industriale dhe tregtare, etj.).
- Mbështetja financiare për palët e treta nuk lejohet.
- Vendndodhja gjeografike: Propozimet duhet të lidhen me aktivitete që zhvillohen në vendet e pranueshme (shih më lart).

Kohëzgjatja: Projektet normalisht duhet të zgjasin ndërmjet 6 dhe 12 muaj.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: 19/09/2024 – 17:00:00 CET (Bruksel).

Për më shumë informacion, ju ftojmë të konsultoni detajet e mëtejshme në linkun e mëposhtëm:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/cerv-2024-citizens-town-tt>

Dhe dokumentin e thirrjes: https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/cerv/wp-call/2024/call-fiche_cerv-2024-citizens-town-tt_en.pdf